



01/Nr. 8408 /2024
Data : 14.10.2024

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e nëntë -IX- për vitin 2024 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 20.08.2024 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Rrezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Buxheti i komunës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2026-2027.
3. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2025.
4. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Buxheti i komunës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2026-2027.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin 2025 është në shumë prej 3,615,457.00 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2026 janë në shumë prej 3,789,234.00 € dhe për vitin 2027 janë në shumë prej 3,967,100.00 €. Janë mbajtur dëgjimet buxhetore dhe propozimet i kemi marr prej qytetarëve dhe janë zhvilluar të gjitha procedurat për çështjen e buxhetit. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Xhevahir Dernjani thekson:- është kërkesë e banorëve të fshatit Paldenicë që rruga Fujza-Vërtomicë të jetë në planifikimet buxhetore.

Sherif Berisha thekson:- nuk e kam të qartë buxhetin e këtij viti se pse është protokolluar tri herë që është dërguar në Ministri . Financimi i investimeve kapitale te pika tre shtimi i kapaciteteve të ujit zero shpenzime, çka planifikohet të investohet te “Varrezat e Dëshmorëve” , në cilat vende planifikohen të rregullohen muret mbrojtëse , cilat rrugë do të shtrohen me kupëza betoni, rregullimi i infrastrukturës në AMF në fshatin Gorancë çka planifikohet të punohet, rregullimi i infrastrukturës shkollore konkretisht çka do të rregullohet. Kërkoj sqarim.

Lindita Ballazhi thekson:- sa i përket protokollimit të buxhetit unë vetëm një herë e kam protokolluar buxhetin dhe numri i protokollit është 04/Nr.7273/ 2024 dhe asnjë numër tjetër të protokollit nuk ka. Projekti për rrugën Fujza-Vërtomicë është te lista e propozimeve dhe në mbledhje dhe varet se a do të votohet si projekt në Kuvendit.

Arsim Dernjani thekson:-sa i përket ndriçimit te Varrezat e Dëshmorëve do të bëhet furnizimi me kabëll adekuate për shkak se është shumë e dobët dhe përmendorja do të bëhet me ndriçim. Sa i përket shtimit të kapaciteteve të ujit menaxhimi i ujit ka kaluar te kompania “Bifurkacioni”.

Hyriete Isufi thekson:- te investimet kapitale te arsimit është mirë me u specifikuar se kulmi është dëmtuar dhe po rrjedh kur bjenë shi. A ka ndonjë të hyrë vetanake që deri më tani nuk është inkasuar në komunën tonë e që në të ardhmen po pritet që me u inkasuar.

Lindita Ballazhi thekson:-projeksioni i të hyrve vetanake vjen prej Ministrisë së Financave dhe bëhet nga ana jonë projeksioni se sa kemi mundësi të i inkasojmë ato lloje të të hyrave duke u bazuar ndër vite. Të hyra të cilat nuk janë inkasuar kemi si llogaritë e arkëtueshme të cilat priten të inkasohen, tatimin në pronë, taksat për ushtrim të veprimtarisë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2026-2027 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- viti shkollorë ka filluar me kohës sipas kalendarit të Ministrisë së Arsimit , janë bërë të gjitha përpjekjet dhe përgatitjet për me filluar mësimi sa më mirë. Materialin e keni pranuar me kohë edhe pse ndoshta ka pasur gabime teknike por për mbledhje të kuvendit do të përcillen me ndryshime.

Xhevahir Dernjani thekson:- a është ndërmarr diçka te salla e sporteve për me i rregulluar dëmet që janë shkaktuar nga breshëri.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj sqarim për pezullimin e vendeve të punës në arsim që po bëhen.

Hisni Luri thekson:- sa i përket dëmeve që janë shkaktuar re salla e sportit dhe te shkolla e mesme “Dardania” jemi në fazën e fundit të përfundim të procedurave të tenderimit. Sa i përket pezullimit të vendeve të punës së arsimtarëve e jona është që me vendosur raportet që ne i shohim ose rekomandimet e mjekut .

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI FILLIMIN E VITIT TË RI SHKOLLORË 2024/2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- në buxhet është mirë që të planifikohen mjetet financiare për Blerja e një kamioni për pastrimin e qytetit, të ketë një kodë buxhetorë për stadiumin e qytetit, Për lehonit shuma nga 100 € të ngritet në 300 €. Është mirë që edhe komuna jonë të bënë kërkesë në Ministri përkatëse për banim të përballueshëm .

Hyriete Isufi thekson:- nesër është dita botërore e pastrimit a ka planifikuar komuna ndonjë aktivitet për shënimin e kësaj dite

Hisni Luri thekson:- për çështjen e ditës botërore të pastrimit takim kemi pasur me drejtorët e shkollave për këtë çështje dhe e kemi ndarë terrenet.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:58.

Procesmbajtësi
Ajni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

